



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:156604

Datë: 28.12.2020

Numri i dokumentit: 01374018

**PKR.nr. 134/20**

## NË EMER TE POPULLIT

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, dhe anetaret e trupit gjykues Islam Thaqi e Sahit Borovci, me sekretaren juridike Fikrete Destani, ne çështjen penale të të pandehurit A. M nga ....rr. “.....” nr. 43, për shkak të veprave penale dhunim nga neni 227 paragrafi 4 nenparagrafi 4.2 e lidhur me paragrafin 1 e nenin 28 dhe vepren penale Dhuna ne familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me par. 1 dhe 2 të KPRK-së, tecilin e mbron Av. Arben Toska nga Gjilanisipas autorizimit, sipas autorizimit, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departametni per Krimet e Renda, PP/I. nr. 150/2020, e dt. 12.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor me dt. 24.12.2020 shpalle ndersa me 28.12.2020 përpilon këtë :

## AKTGJYKIM

**Ndaj te pandehurit A. M nga** babai S... dhe nëna F..., e lindur K..., i lindur me dt... në f. ... K. ... me vendbanim ne ... rr. ...” nr. 43, e k ate kryer shkollen e mesme, murator, I martuar, baba I kater femive, I gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas I Republikes se Kosoves.

## ËSHTE FAJTOR

### I

Me date 26.10.2020, rreth ores 03;30 ne ..., ne rrugen “...” ne shtepine e tyre te perbashket, me perdorim te forces dhe pa pelqimin e bashkshortes se tij, tani te demtuares V. S ka tentuar te kryej akt seksual, ne ate menyre qe pasi njihere kryen aktin seksual, I pandehuri kerkon nga e demtuara te kryej edhe aktin seksual oral, me c’rast I ofrohet asaj, dhe me duar ia ule

koken prane organit te tij gjenital dhe kur e demtuara refuzon me arsyetim se nuk mundet ngase I eshte ngritur tensioni I gjakut, I pandehuri me force ia heqe maicen e pastaj e godet me grusht dore ne fytyre afer syrit te majte e nga dhimbja e demtuara bertet, me c'rast degjojn dy djemt e tyre E... e G...qe ishin ne katin perdhese, arrijn me te shpejt tek ata, duke intervenuar, respektivisht duke e larguar te pandehurin nga nena e tyre, ashtu qe vepra e dhunimit mbetet ne tentative,

**-me c'rast ka kryer vepren penale, penale dhunim nga neni 227 paragrafi 4 nenparagrafi 4.2 e lidhur me paragrafin 1 e nenin 28 KPRK-se.**

## II

Më datë 26.10.2020, rreth orës 03;30, ne Gjilan, ne rr."..." ne shtepine e tyre te perbashket, I pandehuri me qellim te ushtrimit te pushtetit familjar, kontrollit dhe cenimit te dinjitetit tek djali I tij tani I demtuari E.M dhe anetarve te familjes se tij perkatsisht bashkshortes se tij, ka ushtruar dhune ne familje perms keqetrajtimin fizik, ne ate menyre qe deri sa I demtuari E. M ka nderhyre per ta ndare te pandehurin nga sulmi qe ishte duke I bere nenes se tij V..., I pandehuri e godet aty dy here me shuplake dore duke e cenuar me kete rast dinjitetin e tij dhe duke I shkaktuar dhimbje, frike dhe shqetsim tek I njeiti dhe nena e tij.

**- Me cka ka kryer veprën penale, Dhune ne familje nga neni 248 par. 3 e lidhur me paragrafin 1 dhe 2 të KPRK-së**

-Andaj ne baze te nenit 4,38,39,40,42,43,44,46,47,48,49,50,69,70,71,72 e 76 dhe nenit 365 e 450 te KPPK-se,

### **Konstaton;**

- Për veprën penale nga dispozitivi I. këtij aktgjykimi i cakton dënim me burg ne kohezgjatje prej 3 (tri) vite, i cili denim nuk do te egzekutohet me kusht qe ne aft prej 5 (pese) vite mos ta perseris vepren penale, ne te kunderten i njeti do ti zevendsohet me denim me burg efektiv ne kohezgjatje prej 3 (tri) viteve.

- Për veprën penale nga dispozitivi II. i këtij aktgjykimi i cakton dënim me gjobë në shumë prej 500,00 (pesqind) euro dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nentedhjete) dite.

## E GJYKON

**Me dënim me burg ne kohezgjatje prej 3 (tri ) vite,** i cili denim nuk do te egzekutohet me kusht qe ne aft prej 5 (pese) vite mos ta perseris vepren penale, ne te kunderten i njeti do ti zevendsohet me denim me burg efektiv ne kohezgjatje prej 3 (tri) viteve, dhe **me denim me gjobë në lartësi prej 500,00 (pesqind) euro,** dhe me denim me burg ne kohezgjatje prej 90 (nentedhjete) dite, e me kerkesen e te pandehurit denimi me burg I zevendsohet me denim me gjobe ne shume rej 500,00 (peseqind) euro, **ashtu qe te pandehurit I shqiptohet denim I tersishem unik me gjobe ne shume prej 1.000,00 (njimije) euro** të cilin dënim do ta paguaj ne afat prej 15 ditë nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

**Te pandehurit** ne denimin e shqiptuar me gjobe, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dates **28.10.2020 e deri me 18.11.2020,** ashtu qe per qdo dite te qendrimit ne paraburgim, do t'I llogaritet nga 20 euro.

**Detyrohet** i pandehuri, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 (pesedhjete) eurove, në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 50 (pesedhjetë) eurove, si dhe shpenzimet gjyqësore sipas llogarisë perfundimtare.

## A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda, me dt. 12.11.2020, ka ngritur aktakuzen PP.I. nr.150/20, ndaj të akuzuarit A. M, për shkak të veprave penale dhunim nga neni 227 paragrafi 4 nenparagrafi 4.2 e lidhur me paragrafin 1 e nenin 28 dhe vepren penale Dhuna ne familje nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me par. 1 dhe 2 të KPRK-së , ka kerkuar qe I njeti te shpallet fajtor sipas ligjit.

Kryetari I trupit gjykues me datën 18.11.2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri A.M ka deklaruar, se e ka kuptuar aktakuzën e lexuar, e pranon fajsinë lidhur me veprat penale , ku e ka pranuar vepren penale nen dispozitivin II. Te aktakuzes Dhuna ne familje nga neni 248 par. 3 lidhur me paragrafin 1 dhe 2 te KPRK-se, ndersa nuk e ka pranuar vepren penale nen dispozitivin I. te aktakuzes, Dhunim nga neni 227 para. 4 nenparagrafi 4.2 lidhur me par. 1 e nenin 28 te KPRK-së.

Pas marrjes se mendimit nga ana e Prokurorit te shtetit dhe nga Avokati mbrojtës, gjykata ka aprovuar pranimin e fajsisë, për shkak se ky pranim është bërë me vullnetin e të pandehurit dhe është në përputhje të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës: Raporti I oficerit të policisë nr. 2020 CA ... I datës 26.10.2020, fotodokumentacioni nga shkresat e lëndës.

Në seancën e shqyrtimit gjyqsor të mbajtur më 24 dhjetor 2020, kësaj gjykate I ka arritur një marrvëshje për pranimin e fajsisë, e arritur ndërmjet të akuzuarit A.M me Av. E tij Arben Toska dhe Prokurorit të shtetit, për veprën penale Dhunim nga neni 227 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 e lidhur me paragrafin 1 e nenin 28.

Pas marrjes se mendimit nga ana e Prokurorit të shtetit dhe nga Avokati mbrojtës së bashku me të akuzuarin, gjykata ka aprovuar Marrvëshjen e pranimin të fajsisë të datës 23.12.2020, në të cilën palet janë marrë vesh që I akuzuari A.M të dënohet me dënim me burgje në kohezgjatje prej 3 vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht, që I pandehuri më së kryej veprë tjetër penale Brenda periudhës prej 5 vite.

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar, se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza dhe se e njëjta nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit, për veprën penale në dispozitivin II. Te aktakuzës, gjykata ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, ka pasqyruar pranimin e fajsisë, është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj veprë penale, i premton gjykatës që në të ardhmen, nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Sipas Kryetarit të Trupit Gjykues, dënimi me burg në kohezgjatje prej 3 vite, i kushtzuar për 5 vite për dispozitivin I. dënimi me gjobë në lartsi prej 500,00 euro dhe dënimi me burg prej 90 ditësh për veprën në dispozitivin II, zëvendësimi e dënimit me burg në kohezgjatje prej 90 ditësh me dënim me gjobë në lartsi prej 500,00 euro, e pastaj shqyrtimin e dënimit unik në lartsi prej 1.000 euro, është adekuat, duke marrë parasysh peshën e veprës penale. Andaj konform nenit 38 të KPRK-së gjykata vlerëson se me këtë dënim me gjobë, do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit, që në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Te pandehurit i eshte llogaritur edhe koha e qendrimit ne paraburgim.

Gjykata ka detyruar të akuzuarin, që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën paushalle në vlerë prej 50 euro, si dhe 50 euro per viktimat e krimit, kurse shpenzimet e procedures sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate.

Gjykata nuk I ka udhzuar te demtuarit per kerkesen pasurore-juridike, per shkak se kan hequr dore nga e drejta e kompenzimit.

Palet ne procedure kan hequr dore nga e drejta e ankeses.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
Më datë: 28.12.2020**

**Sekretare juridike,  
Fikrete Destani**

**Kryetari i trupit gjykues  
Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** palet kan hequr dore nga e drejta e ankeses.